		<p>F.V Ndares hidraulik, per ndarjen e qarkut primar nga qarku sekondar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Materiali i trupit: çelik;</li> <li>- Presion maksimal i punes: 10 bar;</li> <li>- Temperatura: 0 ÷ 100°C</li> <li>- Lidhjet me flanaxha: DN 80</li> <li>- Lidhja me kundra flanh: UNI 2278</li> </ul>		



	<p>F.V Ene zgjerimi me diafragme per linjat e terminaleve ngrohes te godines ekzistuese, dhe palestres</p> <p>Volumi 80 lit</p> <p>Diametri 400 mm</p> <p>Lartesia 820 mm</p> <p>P.max 6 bar</p> <p>T.punes -10÷99°C</p> <p>Lidhja Ø3/4"</p>	
	<p>F.V Ena e zgjerimit te kaldajes eshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kapaciteti: 200 litra;</li> <li>- Dimensionet: 600 mm;</li> <li>- Lartësia: 812 mm;</li> <li>- Presioni maksimal: 6 bar;</li> <li>- Temperatura e sistemit: -10°C deri ne +99°C;</li> <li>- Lidhja: Ø 3/4".</li> </ul>	
	F.V Tubo PE - HD Ø 75x6.8 mm, PN16	
	F.V Rakorderi (bryla, ti, reduksion, etj)	
	F.V Valvol nderprerese me sfere DN 65 (2½")	
	F.V Fiter uji me rrjete DN 65, Pn 6 bar	
	F.V Mates uji DN 65, Pn 6 bar	
	F.V Valvol moskthimi DN 65, Pn 6 bar	
	F.V Tubo PE - HD Ø 75x6.8 mm, PN16	
	F.V Tubo PE -Xa, DN 50 (Ø63 X 8.6) mm	
	F.V Tubo PE -Xa, DN 40 (Ø50 X 5.9) mm	
	F.V Tubo PE -Xa, DN 32 (Ø40 X 5.5) mm	
	F.V Tubo PE -Xa, DN 25 (Ø32 X 4.4) mm	
	F.V Tubo PE -Xa, DN 20 (Ø25 X 3.5) mm	
	F.V Tubo PE -Xa, DN 15 (Ø20 X 2.8) mm	
	F.V Tubo PE -Xa, DN 12 (Ø16 X 2.2) mm	
	F.V Rakorderi PE-Xa (bryla, ti, reduksion, etj)	
	F.V Termoizolim armoflex per tubo PE-Xa, DN15 (Ø20 X 2.8) mm	
	F.V Termoizolim armoflex per tubo PE-Xa, DN12 (Ø16 X 2.2) mm	
	F.V Minivalvula nderprerese per pajisjet sanitare Ø 1/2"	
	F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 3"	
	F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 2½"	
	F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 2"	

	F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 1½"		
	F.V Valvol nderprerese me sferë DN 65 (2½")		
	F.V Valvol nderprerese me sferë DN 65 (2½")		
	F.V Valvol nderprerese me sferë DN 40 (1½")		
	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d110		
	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d75		
	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d50		
	F.V Bryla RAU - PP d110 α = 45°		
	F.V Bryla RAU - PP d50 α = 45°		
	F.V Reduksion RAU - PP d110/d75		
	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d125		
	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d110		
	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d75		
	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d50		
	F.V Brag 45° d125/110		
	F.V Brag 45° d110/75		
	F.V Brag 45° d75/50		
	F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave		
	F.V Shtrese rere + transport		
	F.V Puseta betoni (60 x 60 ) cm, me kapak gize		
	F.V Tubo shkarkimi PE d125		
	F.V Tubo shkarkimi i rrullsur PEHD d160		
	F.V Tubo shkarkimi i rrullsur PEHD d200		
	F.V Tubo shkarkimi i rrullsur PEHD d250		
	F.V Rakorderi per tuba PEHD (Bryla, reduksione, braga, manikota, etj.)		
	F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave		
	F.V Shtrese rere + transport		
	Pusete shkarkimi b/a, 50 x 50 cm, h = 100 cm		
	F.V Pilete Ø110 per shkarkimin e ujrave te tarraces		
	F.V Varange Ø110 per shkarkimin e ujrave te tarraces		
	F.V Tubo GMX shkarkimi Ø 110 mm		
	F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 125 mm		
	F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 160		

		mm		
		F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 200 mm		
		F.V Tubo PEHD I magjstralit I rrudhosur Ø 250 mm		
		F.V Element ndihmes dhe rakorderi per tuba PEHD		
		F.V Tubo i rrudhosur (CORRUGATED), I perforuar 220o per drenazhimin e ujrave nentokesore te themeleve. D 250mm, SN8 i kompetuar me te gjithë aksesoret		
		F.V Rezervuar zingato per furnizimin me uje, kapaciteti 5 000 lit, De=1600 mm, H=2660 mm, lidhjet 1¼".		
		F.V Grupi i furnizimit me uje + paneli elektrik (INVERTER) - Prurja: 19 m³/h, - Prevalenca: 60 mKH2O, - Fuqia elektrike: 2x5.5 kË, rryma 2x10 A, - Ushqimi: 3F/400V/50Hz, - Lidhjet: DN 65, PN 16 E kompletuar me te gjithë aksesoret e nevojshem.		
		F.V Autoklave 500 l Presioni max. i punes: 16 bar Presioni i ngarkimit : 1.5 bar Kapaciteti : 500 lit Diametri : 650 mm Lartesia: 1865 mm Lidhjet : 1¼"( DN 32 )		
		F.V Boiler elektri 100 lit, tip horizontal + aksesoret hidraulike		
		F.V Boiler elektri 12 lit + aksesoret hidraulike		
		F.V Lavaman tualeti + mishelator		
		F.V Lavamane lab.antiacid ( 510x360x300) mm & suporte + mishelatore		
		F.V ĘC- alla turka + kuti shkarkuese		

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", lidhja 3, përkatësisht si më poshte:

### *N.P. 1 Punime gjermimi në tokë*

*Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.*

### *N.P. 2 Ndërtime civile e industriale*

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

### *N.P. 3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash*

*Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

### *N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore*

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e **riaftësimin natyror**, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe **mbetjeve inerte**.*

### *N.S -1 Punime për prishjen e ndërtimeve*

*Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

### *N.S-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaxi, mirëmbajtja e tyre*

*Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavaxit të gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me*

*punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

**N.S-4** *Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese*

*Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.*

**N.S – 8** *Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, **struktura metalike** dhe druri*

*Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të parandëruar. Prodhimin në kantjer dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

**N.S - 12** *Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit*

*Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve 253 pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.*

**N.S- 14** *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV*

*Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

**N.S - 18** *Punime topogjeodezike*

*Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

**2.4.1** *Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë*

se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë

*(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit).*

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit”. Gjithashtu, duke qenë se fondi limit për këtë procedurë prokurimi është 108 411 331 (njëqind e tetë milion e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH, jemi në kushtet e parashikuara në pikën 2.1 të Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku përcaktohet se: “Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimit”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë

*të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.*

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipozitave ligjore në fuqi.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë të vërtetuar **me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse / licencësi** dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) InxhinierNdertimi
- 1 (një) InxhinierMekanik
- 1 (një) InxhinierElektrik
- 1 (një) InxhinierTopograf/ Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) InxhinierMjedisi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori fitues **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë / licencë.

***Sqarim: Për plotësimin e këtij kriteri OE mund të paraqesë ose diplomën përkatëse ose licencën individuale. Në të dyja rastet kriteri konsiderohet i plotësuar.***

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit

Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4.2, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierit të ndërtimit, mekanik, elektrik, hidroteknik, topograf, arkitektështë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kërkesa që të gjithë inxhinierët e mësipërm të jenë drejtues teknik bazohet në vendimin nr. Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi”, në përkufizimet dhe nenet si më poshte:

*“Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.”*

KREU V Mënyra E Klasifikimit Të Shoqërive, pika 1. *“Klasifikimi i shoqërive a) Shoqëria vendoset paraprakisht në nivelin (klasën) e pasqyruar në lidhjen nr.4, ku përfshihet vlera e punimeve të kryera gjatë 4 viteve të fundit për kategorinë që klasifikohet. Shoqëria qëndron në të njëjtin nivel klasifikimi apo zbret në një më të ulët në varësi të pikëve që **përfiton nga përvoja e drejtuesit teknik të shoqërisë** për kategorinë që klasifikohet dhe pikët nga kapaciteti financiar nëpërmjet bilanceve, të llogaritura si në vijim....”*

*“KREU IVDrejtuesi Teknik i Shoqërisë Dhe Papajtueshmëria Me Këtë Detyrë, pika 1,a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me **arsimin universitar përkatës** (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune **jo më pak se 5 vjet nga diplomimi.**, b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në **diplomimin dhe përvojën personaletë drejtuesit/drejtuesve teknikë**, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.”*

**Inxhinier Ndërtimi** – për punimet e ndërtimit të cilat i përkasin pikave të licencës NP.1, NP.2, NS.1, NS2. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e projektit teknik **As built** si dhe projektit të mirëmbajtjes së objektit në përfundim të punimeve, pasi është ndër dokumentacionet bazë për aplikimin për certifikatë përdorimi, në bazë të VKM 408 datë 13.05.2015, i ndryshuar neni 27/2 “g) projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar) gj) “Projekti për mirëmbajtjen e objektit”, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;”, si dhe bazuar në UKM nr. 2 pika 1.2 Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave



ligjore në fuqi.” Si dhe pika 2. Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesiteknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësiteknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinierindërtimi.”

Në përzgjedhjen e inxhinierit të ndërtimit me profilizimin përkatës për punimet e kategorizuara sipas pikave të licencës, jemi bazuar kryesisht në VKM 943 datë 28.12.2016 Lidhja 5 “Kushte Dhe Kriteria Specifike që Kryesisht Duhet Plotësuar Për Të Fituar Kategoritë në fushat e Mbikëqyrje Dhe Kolaudit të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”, e cila jep një pasqyrë më të qartë të profilizimit të arsimit të inxhinierëve sipas pikave të licencës. Në VKM Nr.42, datë 16.1.2008 në lidhjen nr. 4 jep një profilizim arsimor të inxhinierëve, i cili nuk është i përditësuar me profilizimet aktuale sipas fakulteteve dhe degëve të ndryshme të Universitetit Politeknik të Tiranës, në ndryshim nga VKM 943 datë 28.12.2016 i cili është i përditësuar me titujt e diplomave sipas sistemit të Bolonjës dhe profilizimeve aktuale të Universitetit Politeknik të Tiranës, pa përjashtuar diplomat e marra në profilizime të ndryshme përgjatë viteve të kaluara.

*NP-1. Punime gërmimi në tokë*

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit.*

*NP-2. Ndërtime civile dhe industriale*

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt.*

*NP-3. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada*

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt.*

*NS-1. Punime për prishjen e ndërtimeve*

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit.*

*NS-2. Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre*

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit dhe profilet e inxhinierit Mekanik në Impiante/Energjetikë/Termoteknikë.*

*NS-4. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese*

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt.*

*NS-8 b. Struktura metalike*

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik)/në profilin e Inxhinierit Mekanik në industri/konstruksion.*

**Inxhinier Mekanik** – për punimet e mekanike sipas pikave të licencës NS-2, NS – 12 dhe NS - 8. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e projektit mekanik **As built**, si dhe projektit të mirëmbajtjeës së objektit në përfundim të punimeve, pasi është ndër dokumentacionet bazë për aplikimin për certifikatë përdorimi, në bazë të VKM 408 datë 13.05.2015, i ndryshuar neni 27/2 “gj) “Projekti për mirëmbajtjen e objektit”, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;”. Në përzgjedhjen e inxhinierit mekanik me profilizimin përkatës për punimet e kategorizuara sipas pikave të licencës, jemi bazuar kryesisht në VKM 943 datë 28.12.2016 Lidhja 5 “Kushte Dhe Krite Specifike që Kryesisht Duhet Plotësuar Për Të Fituar Kategoritë në fushat e Mbikëqyrje Dhe Kolaudimit të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”, si më poshte:

**NS-2. Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre**

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit dhe profilet e inxhinierit Mekanik në Impiante/Energjetikë/Termoteknikë.*

**NS-12. Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit**

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Mekanik në Impiante/ Energjetikë /Termoteknikë/Industri ose profili Mjedis Energjetikë, të Inxhinierisë së Ndërtimit.*

**Inxhinier Elektrik** – për punimet elektrike në përputhje me pikat e licencës NS-14. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e projektit elektrik **As built** në përfundim të punimeve, si dhe projektit të mirëmbajtjeës së objektit në përfundim të punimeve, pasi është ndër dokumentacionet bazë për aplikimin për certifikatë përdorimi, në bazë të VKM 408 datë 13.05.2015, i ndryshuar neni 27/2 “gj) “Projekti për mirëmbajtjen e objektit”, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;”, pasi është ndër dokumentacionet bazë për aplikimin për certifikatë përdorimi.

Në përzgjedhjen e inxhinierit elektrik me profilizimin përkatës për punimet e kategorizuara sipas pikave të licencës, jemi bazuar kryesisht në VKM 943 datë 28.12.2016 Lidhja 5 “Kushte Dhe Krite Specifike që Kryesisht Duhet Plotësuar Për Të Fituar Kategoritë në fushat e Mbikëqyrje Dhe Kolaudimit të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”, si më poshte:

**NS-14. Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.**

*Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektrik/Elektronik.*

**Inxhinier Topograf/ Gjeodet/ Markshajder** – për punimet e palestres si piketimi, kontrolli etj, në përputhje me pikën e licencës NS-18. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e planvendosjes përfundimtare **As built** në përfundim të punimeve, në bazë të VKM 408 datë 13.05.2015, i ndryshuar neni 27/2 pasi është ndër dokumentacionet bazë për aplikimin për certifikatë përdorimi.

**Arkitekti** – Për punimet e shtresave dhe rifiniturave, në përputhje me pikat e licencës NP-3 dhe NP-4. Duke qenë se kemi të bëjmë me rikonstrukcion total të shkollës, që përfshin punime shtresash, lysterje, rifinitura etj., është e nevojshme prania e arkitektit në përzgjedhjen e materialeve, ngjyrave dhe vendosjen e tyre, pasi në projekt zbatim nuk janë specifikuar të gjitha detajet arkitektonike të objektit, si dhe në bashkëpunim me inxhinierin e ndërtimit kryen kontrollin e shtresave dhe detajeve të tjera teknike gjatë zbatimit të punimeve. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e projektit arkitektonik **As built** në përfundim të punimeve si dhe projektit për mirëmbajtjen e objektit, pasi janë ndër dokumentacionet bazë për aplikimin për certifikatë përdorimi, në bazë të VKM 408 datë 13.05.2015, i ndryshuar neni 27/2 “g) *projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar); gj) “Projekti për mirëmbajtjen e objektit”, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;*”.

Në përzgjedhjen e arkitektit me profilizimin përkatës për punimet e kategorizuara sipas pikave të licencës, jemi bazuar kryesisht në VKM 943 datë 28.12.2016 Lidhja 5 “*Kushte Dhe Krite Specifike që Kryesisht Duhet Plotësuar Për Të Fituar Kategoritë në fushat e Mbikëqyrje Dhe Kolaudimit të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim*”, si më poshte:

*NP-3. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt.*

*NS-4. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit/Arkitekt.*

**Inxhinier mjedisi** – Është përgjegjës për marrjen e masave për administrimin e mbetjeve të ngurta (sic shprehet eksperti i mjedisit në faqen nr. 51 të raportit të VNM, ku citohet: “*Mbetjet që gjenerohen nga veprimtaria ndërtimore, të sistemohen të ndara e të vecuara sipas llojit të tyre, në vende të paracaktuara që më parë për qëndrimin e tyre provizor ; → Mbetjet të largohencdo ditë nga sheshi i ndërtimit dhe të dërgohen në vendgrumbullimin e përcaktuar nga pushteti vendor; → Transporti i tyre të bëhet në orar me trafik të pakësuar; → Për transportin e materialeve dhe të mbetjeve të përdoren makina të mbuluara dhe që nuk rrjedhin → Mbetjet toksike të dërgohen në një vend depozitim të miratuar posacerisht për to → Të pastrohen menjëherë rrjedhjet, derdhjet, pikimet për të parandaluar ndotjen e tokës → Të shtrohen me zhavor dhe të miratohen rrugë brënda sheshit të ndërtimit; → Shërbimet dhe riparimet e*

*makina e të paisjeve të bëhen sipas grafikut dhe në vende të përcaktuara për këtë qëllim; → Të lahen gomat e atomjeteve para daljes nga sheshi I ndërtimit.”, Mbetjet Gjatë fazës së ndërtimit: Objektivi: të parandalojë, korrigjojë ose zbusë efektet negative nga grumbullimi i mbetjeve të gjeneruara në kantier. Mbetjet e gjeneruara në vend do të jenë kryesisht mbetje nga prishjet, inerte, mbetje urbane, mbetje jo të rrezikshme. Megjithatë, disa mbeturina të rrezikshme mund të krijohen në punime siç janë lecka për pastrimin e vajrave, absorbuesit e ndotur, veglat e kontaminuara dhe paketimet e tjera etj që vijnë si pasojë e derdhjeve aksidentale. Një menaxhim jo korrekt i mbetjeve do të përbëjë problemin kryesor në kantier. Do të përgatitet një plan menaxhimi të mbetjeve i cili duhet të zbatohet me korrektësi. Mbetjet urbane, nga aktiviteti i punonjësve të kantierit duhet të grumbullohen në kosha të vendosur në kantier për tu depozituar më tej në kontenerët më të afërt të vendosur nga bashkiatë cilët i transportojnë në venddepozitimin përfundimtar. Këto mbetje do të përfaqësohen ngaplastika, qelqi, letra, metale, mbetje të biodegradueshme. Sa i takon mbetjeve inerte nga prishja ato do të transportohen në venddepozitimin përfundimtar të bashkisë. Ndërsa dherat dhe shtresa vegjetale duhet të grumbullohen në një vend të caktuar në kantier. Një pjesë e dherave do të dërgohet në venddepozitimin e përcaktuar nga bashkia, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe një pjesë, rreth 510 m<sup>3</sup>, do të ripërdoret ngashoqëria ndërtuese për qëllime rehabilitimi, krijimit të hapësirave të gjelbërta. Grumbullimi i mbetjeve në kantier duhet të jetë i diferencuar.”*

Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e planit dhe marrjen e masave për zbutjen e ndikimit në mjedis gjatë punimeve të ndërtimit, sic shprehet në pikën e) fq. 55 të raportit të VNM-së, ku citohet: “Masat që duhen konsideruar për ndikimin në mjedis janë: Lagia e shesheve të pashtruara gjatë punimeve të ndërtimit dhe larja e automjeteve përpara daljes nga kantieri në mënyrë që të mos ngrihen grimca të ngurta në ajër. Mbetjet e ngurta që do të prodhohen në kantier të depozitohen në vendet e përcaktuara nga njesia e Qeverisjes vendore dhe të vendosen në kosha të mjaftueshëm për numrin e popullsisë. Sistemi i shkarkimit të ujërave urbane të jete i lidhur me sistemin e kanalizimeve të zonës fillimisht në rrjetin egzistues, në rast se do të ndërtohet ndonjë i ri. Perdorimi i materialeve termoizoluese në ambiente dhe shmangia e sistemit ngrohes me lende si nafta apo dru zjarri. Aplikimi i sistemit të ndriçimit natyral dhe i atyre me llamba led. Të sistemohet vendi pas përfundimit të objektit karabina. Të respektohet oraret e qetsisë publike dhe të mos punohet në orare të vona. Automjetet e transportit të qarkullojnë në shpejtesë të ulët në zonat e banuara. Gjatë transportit të perdoren mushama nga kamionet në mënyrë që të mos ketë dhe apo inerte në rrugë. Automjetet e transportit para daljes nga kantieri të lahen dhe të pastrohen. Pas miratimit të lejes zhvëllimore të sigurohet menjëherë një vend i miratuar nga autoritetet për depozitimin e mbetjeve inerte që do të largohen nga objekti. Duhet të tregohet kujdes në respektimin rigoroz të kushteve teknike në objekt për të reduktuar mundësitë e rënies së zjarrit dhe avaritë në sistem duke shmangur ndotjen në mjedis. Parandalimi i shkarkimeve të mbetjeve në mjedisin e zonës lidhur me mbetjet e grumbulluara të menaxhohen në bashkëpunim me subjekte të licensuara ose me subjektin e grumbullimit të mbetjeve. Punohet të jete të trajtuar paraprakisht dhe të jete vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë

*proceseve te punes. Mbjellja ne territor ka koeficient mbi optimalen i lihet detyre te vazhdoje te rritet, me brez tjetër pemesh te larta pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peizazh. Te vazhdohet te kryhet menaxhimi i integruar i mbetjeve, ne menyre qe te mos jene nje problem mjedisor i zones dhe mjedisit uhor.”*

Po ashtu bazuar në VKM 943 datë 28.12.2016 Lidhja 5 “Kushte Dhe Kriteria Specifike që Kryesisht Duhet Plotësuar Për Të Fituar Kategoritë në fushat e Mbikëqyrje Dhe Kolaudimit të Punimeve Të Zbatimit Në Ndërtim”, inxhinieri i mjedisit në bashkëpunim me inxhinierin mekanik do të drejtojë punimet e kategorisë NS 12, si më poshte:

NS-12. Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit. Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Mekanik në Impiante/ Energjetikë /Termoteknikë/Industri ose **profili Mjedis Energjetikë**, të Inxhinierisë së Ndërtimit.

**2.4.2** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) InxhinierNdertimi
- 1 (një) teknik ndërtimi
- 1 (një) teknik topograf / Inxhinier topograf
- 1 (një) inxhinier hidroteknik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori fitues **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontratë pune e vlefshme, diplomë / licencë / certifikaten e kualifikimit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar si drejtues teknik. Staf mbështetës (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

**Inxhinier Ndertimi** është i nevojshëm pasi do të merret me organizimin e punimeve krahas drejtuesit teknik, si dhe në bashkëpunim me fuqinë punëtore të kontraktorit do të sigurohet që punimet të realizohen në cilësinë e duhur dhe sipas grafikut të punimeve.

**Tekniku topograf** është i nevojshëm krahas inxhinierit topograf, pasi duke patur parasysh edhe grafikun e punimeve, ka punime që mbivendosen, të cilat është menduar se mund të menaxhohen nga inxhinieri topograf) dhe punimet për sisteminin e oborrit, për të cilat është e mjaftueshme asistenca e teknikut topograf.

**Tekniku i ndërtimit** në bashkëpunim me dy inxhinierët e ndërtimit, do të bashkërendojë punimet me fuqinë punëtore të kontraktorit për të garantuar zbatimin e punimeve sipas KTZ dhe grafikut të punimeve.

**Inxhinier hidroteknik** – është i nevojshëm sepse duhet të zbatojë dhe të përmirësojë (nëse është rasti) projektin e furnizimit me ujë dhe shkarkimeve të ujrave të zeza.

**2.3.7** Operatori/et ekonomik duhet të kenë personel të kualifikuar/çertifikuar (**listëpagesa apo marrëdhënie kontraktore me persona apo subjekteve të specializuara në fushën perkatese**), Për secilin duhet të paraqiten sipas rasteve specifike: Kontratë individuale të punës dhe Diplomë/certifikate/ urdher mjeku:

- **1 (një) punonjes te pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq, ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë,**
- **1 (nje) ekspert zjarrefikes te certifikuar (i pajisur me Certificate): Ekspert ne fushen e Mbrojtjes nga Zjarri dhe per Shpetimin**
- 1 (një) punonjes të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier “.
- 6 (Punojes) punonjes të certifikuar për punime që do të kryhen në lartësi (IRATA ose ekuivalent me të) , per te cilen duhet te paraqese kontraten e punes dhe certifikatat perkatese.
- 1 (një) mjek të përgjithshëm
- **1 (një) inxhinier te pajisur me certifikate Audites Energjie ne ndertesa, te pajisur me certificate te leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori fitues **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kontrata pune të vlefshme ose listëpagesa të konfirmuar nga Administrata Tatimore**
2. **Certifikata / kualifikimet përkatëse për secilin**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme mbështeten në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"; V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"; ligjin Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga zjari apo çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kërkesa për mjekun e shoqërisë është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 692 datë 13.12.2001, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, neni 12/2 që parashikon shprehimisht se, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

Për vendosjen e kriterit “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**” jemi bazuar në VKM 312 datë 05.05.2010 “*Për Miratimin E Rregullores "Për Sigurinë Në Kantier"*”, neni 2 pika f) “*koordinatori për realizimin e punimeve është koordinatori në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të veprës, i ngarkuar nga porositiësi ose nga administruesi i punimeve, për kryerjen e detyrave për të cilat flitet në nenin 5;*”, si dhe neni 5: “*Detyrat e koordinators për realizimin e punimeve. Gjatë realizimit të veprës, koordinatori për*

realizimin e punimeve merr masat që: a) Të verifikojë zbatimin nga ana e subjekteve që realizojnë punimet dhe nga të vetëpunësuarit, të rregullave që lidhen me ta, që i përmban plani i sigurisë dhe i koordinimit sipas aneksit VI dhe aplikimin korrekt të procedurave përkatëse të punës; b) Të verifikojë përshtatshmërinë e planit operativ të sigurisë, që duhet konsideruar plan plotësues i hollësishëm i planit të sigurisë dhe koordinimit sipas aneksit VI, duke siguruar përputhshmërinë me këtë të fundit dhe të përshtatë planin e sigurisë e të koordinimit me dosjen për të cilën flitet në nenin 4, pika 1, germa "b", në varësi të zhvillimit të punimeve dhe të modifikimeve të mundshme të bëra, duke vlerësuar propozimet e subjekteve që realizojnë punimet për të përmirësuar sigurinë në kantier. Ai verifikon nëse subjektet që realizojnë punimet përshtatin planet përkatëse operative për sigurinë, kur është e nevojshme, sipas përcaktimeve të aneksit VI; c) Të organizojë çdo 3 muaj mbledhjen e këshillit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe organizimin e mbledhjes së jashtëzakonshme në rast të ndodhjes së një aksidenti në kantier, përfshirë këtu të vetëpunësuarit, bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve, përveç informimit të tyre reciprok;<sup>40</sup> d) Të verifikojë vënien në jetë se çfarë është parashikuar në marrëveshjet midis palëve me qëllim që të organizojë koordinimin midis përfaqësuesve të sigurisë e finalizuar kjo me përmirësimin e sigurisë në kantier; e) Të njoftojë porositësit ose administruesit e punimeve, nëpërmjet njoftimit me shkrim, subjekteve dhe të vetëpunësuarit, për moszbatimin e dispozitave të neneve 7, 8 dhe 9 dhe të urdhëresave të planit për të cilin flet aneksi VI dhe të propozojë pezullimin e punimeve, largimin e subjektit ose të vetëpunësuarve nga kantieri ose zgjidhjen e kontratës. Në rast se porositësi ose investitori nuk merr asnjë masë në lidhje me sinjalizimin, pa një motiv të arsyeshëm, koordinatori për realizimin e punimeve merr masat për t'i bërë njoftimin e mos përmbushjes së rregullave punëdhënësi inspektoratit sanitar shtetëror në atë territor dhe drejtorisë rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës; f) Të pezullojë në rast rreziku të madh dhe të dukshëm ose të papritur, punimet e veçanta deri në verifikimin e marrjes së masave të përshtatshme nga subjektet e interesuara; g) në rastet për të cilat flitet në nenin 3, pika 4, koordinatori për realizimin e punimeve, përveçse kryen detyrat për të cilat flitet në pikën 1, harton dhe planin e sigurisë e të koordinimit dhe përgatit dosjen për të cilën flitet në nenin 4, pika 1.”. Në asnjë nga pikat e cituara më sipër, ligji nuk e ngarkon përgjegjësin e sigurisë dhe mbrojtjes në punë të ofrojë ndihmën e parë për punonjës të dëmtuar. Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 10 243 date 18.02.2010 neni 8 në të cilin citohet: “**Neni 8 Ndhima e parë, mbrojtja kundër zjarrit dhe evakuimi i punëmarrësve, rreziqet e rënda dhe të menjëhershme**

*1. Punëdhënësi:*

- a) merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë, mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin në rastet kur ka rrezik për të ndodhur ngjarje;
- b) merr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve e të personave të tjerë të pranishëm;
- c) organizon dhe siguron evakuimin e shpëtimit e punëmarrësit në rast ngjarjesh ose aksidentesh të papritura, që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre;



*ç) trajnon personat, që do të kryejnë evakuimin e shpëtimit dhe siguron, me anë të personave të trajnuar, realizimin e evakuimit e të shpëtimit, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së shpejtë me pajisjet e nevojshme;*

*d) harton një plan për evakuimin dhe shpëtimit në situata emergjente, të cilin ia bën të ditur të gjithë punëmarrësve, si dhe kryen ushtrime praktike, të paktën një herë në dy vjet, në përputhje me këtë plan;*

*dh) organizon dhe jep ndihmën e shpejtë për punëmarrësit e dëmtuar në punë ose punëmarrësit, që pësojnë sëmundje të papritura, derisa ata të dërgohen në një institucion të kujdesit shëndetësor;*

*e) cakton të paktën një punëmarrës të trajnuar, i cili mund të japë ndihmën e shpejtë, të fikë zjarrin ose të kryejë veprime shpëtimi a evakuimi dhe, nëse ka më tepër se 20 persona, që punojnë në të njëjtin mjedis pune, duhet të ketë të paktën dy punëmarrës të trajnuar për ofrimin e këtyre shërbimeve.*

*2. Punëdhënësi vendos pajisje të nevojshme në dispozicion të punëmarrësve përgjegjës për ndihmën e shpejtë, shpëtimit dhe evakuimin në rast zjarri.*

*3. Punëdhënësi duhet:*

*a) të informojë, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjithë punëmarrësit që janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj një rreziku të rëndë dhe të menjëhershëm, për rrezikun e për masat e marra ose që do të merren për mbrojtjen e tyre;*

*b) të japë udhëzimet e duhura e të marrë masa për t'i lejuar punëmarrësit, në rast rreziku të rëndë, të menjëhershëm dhe të pashmangshëm, të ndalojnë veprimtarinë e tyre dhe të lënë në mënyrë të menjëhershme vendin e punës, duke kaluar në një vend të sigurt;*

*c) me përjashtim të ndonjë rasti shumë të motivuar, të mos u kërkojë punëmarrësve rifillimin e punës, kur rreziku i rëndë dhe i menjëhershëm vazhdon (është prezent).*

*4. Punëmarrësi, i cili në rast rreziku të rëndë, të menjëhershëm dhe të pashmangshëm, largohet nga vendi i punës ose zona e rrezikshme, nuk mund të cenohet nga punëdhënësi, por duhet të mbrohet kundrejt çdo pasoje dëmtuese dhe të pajustificuar.*

*5. Punëdhënësi siguron që çdo punëmarrës, në rast rreziku të rëndë dhe të menjëhershëm për sigurinë e tij vetjake dhe atë të personave të tjerë dhe në rast pamundësie kontakti me superiorin hierarkik përgjegjës, duke u mbështetur në njohuritë e tij e në mjetet teknike që disponon, të mund të marrë masat e duhura për të shmangur pasojat e një rreziku të tillë. Veprimi i tij nuk cenon atë, me përjashtim të rasteve, kur ai ka vepruar me pakujdesi ose ka neglizhuar rëndë.”.*

**Për sa më sipër, në gjykimin tonë Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë kantier dhe eksperti për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave kanë funksione, detyra dhe përgjegjësi të ndryshme nga njeri tjetri, pasi njëri është për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin e aksidenteve / sëmundjeve profesionale në punë si dhe kontrollin e zbatimit të këtyre masave, ndërsa tjetri është për ndërhyrjet në rast të ndodhjes së aksidenteve në punë.**

Për sa i përket kërkesës për “Ekspert zjarrfikës”, jemi bazuar në ligjin nr. 152/2015 ku në nenin 3 ndër të tjera citohet: “**29. “Ekspert zjarrfikës privat” është personi fizik dhe juridik, i certifikuar, i**

*cili harton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kryen aktin e ekspertizës për zjarrin e rënë, kryen trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas dispozitave të këtij ligji.”. Gjithashtu jemi bazuar edhe në nenin 4 të VKM 312 datë 05.05.2010 Aneksi IV “Kërkesa Minimale Me Karakter Të Përgjithshëm Për Vendet E Punës Në Kantier”, pika 4 në të cilën citohet: “Njoftimi dhe mbrojtja nga zjarri 4.1 Sipas karakteristikave të kantierit, të dimensioneve dhe të përdorimit të lokaleve, të pajisjeve që përdoren, të karakteristikave fizike dhe kimike të substancave ose të materialeve që gjenden në të, si edhe të numrit maksimal të personave që mund të gjenden, **duhet të parashikohet një numër i mjaftueshëm pajisjesh të përshtatshme kundër zjarrit dhe nëse është e nevojshme njoftues zjarri ose sisteme alarmi.** 4.2. Këto pajisje për mbrojtjen kundër zjarrit, njoftues zjarri dhe sisteme alarmi **duhet të kontrollohen rregullisht dhe të mbahen në gjendje pune.** Në intervale të rregullta **duhet të zhvillohen prova dhe ushtrime të përshtatshme kontrolli.** 4.3 Pajisjet joautomatike të mbrojtjes kundër zjarrit duhet të jenë të arritshme dhe të manovrueshme lehtësisht. Ato duhet të jenë subjekti i një sinjalistike konform rregullave kombëtare dhe të përqasin (transpozojnë) direktivën 77/576/KEE. Sinjalistika duhet të jetë mjaft rezistente dhe të jetë e vendosur në vende të përshtatshme.”. Eksperti zjarrfikës duhet të hartojë planin e mbrojtjes nga zjarri dhe planin e evakuimit gjatë fazës së zbatimit të punimeve.*

Disa nga funksionet e ekspertit zjarrfikës mbivendosen me funksionet e ekspertit të ndihmës së parë dhe emergjencave, por duke patur parasysh tipologjinë e objektit, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që në kantier në pjesën më të madhe të kohës do të jenë më shumë se 20 punonjës, përmbushim detyrimet e ligjit nr. 10 243 date 18.02.2010 neni 8 pika e.

**2.4.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 3 (tre) punonjës elektrikiste
- 2 (dy) punonjës hidraulike
- 3 (tre) punonjës karpentier
- 1 (një) punonjës mekanik
- 3 (tre) muratorë
- 2 (dy) pllakashtrues
- 1 (një) hidroizolues
- 2 (dy) bojaxhinj
- 1 (një) instalues termohidraulik
- 1 (një) teknik kaldajash
- 1 (një) hekurkthyes

- 3 (tre) suvatues
- 2 (dy) montatorë
- 2 (dy) punonjës të specializuar për konstruksione metalike

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar sipas pikës 2.4.2, (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë stafin teknik të mësipërm, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit, për natyrën komplekse të nderhyrjeve në këto vepra e cila parashikon jo vetëm nderhyrje të tipit rrafshor strukturor por dhe ndërtime të reja komplekse të natyrave të punës dhe materialeve të shumëllojshme (b/a, metalike etj)

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik, gjë e cila është kërkuar për të garantuar AK për cilësinë e punimeve që do të kryhen si dhe të garantojë që proceset kryesore të punës të kryhen nga specialistët përkatës. Përzgjedhja e stafit të mësipërm është bërë bazuar në zberthimin e preventivit sipas orëve të punës si dhe bazuar në eksperiencat e mëparshme të AK. Kërkesa për stafin teknik për punimet elektrike është mbështetur gjithashtu edhe në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

**2.4.4**Një punësim mesatar i të paktën **80 (tetëdhjetë)** personave (përfshirë stafin teknik drejtues dhe mbështetës, punëtorët dhe manovratorët), të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3(tre) **muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muaj të fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 muaj të fundit të deklaruar.

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve

*ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për njëpunësim të paktën 80 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018).

***Punime dhe mbushje*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 5 javë x 7 ditë x 8 orë = 280 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 1709 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati I punimeve sipas grafikut = 6.1 ≈ 6 punëtorë*

***Punime prishje*** – Afati I punimeve sipas grafikut = 5 javë x 7 ditë x 8 orë = 280 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 1293 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati I punimeve sipas grafikut = 4.6 ≈ 5 punëtorë*

***Punime betoni*** – Afati I punimeve sipas grafikut = 5 javë x 7 ditë x 8 orë = 280 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 2132 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati I punimeve sipas grafikut = 7.61 ≈ 8 punëtorë*

***Punime hekuri*** – Afati I punimeve sipas grafikut = 5 javëx7ditëx8orë= 280 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 108.6 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati I punimeve sipas grafikut = 0.39 ≈ 1 punëtorë*

***Punime murature*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 5 javëx7ditëx8orë= 280 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 1206 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati I punimeve sipas grafikut = 4.3 ≈ 4 punëtorë*

***Punime çatie***– Afati i punimeve sipas grafikut = 5 javëx7ditëx8orë= 280 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 1876.5 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati I punimeve sipas grafikut = 6.7 ≈ 7 punëtorë*

***Punime shtresash*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 9 javëx7ditëx8orë= 504 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 6059 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati i punimeve sipas grafikut = 12 punëtorë*

***Punime suvatimi dhe veshje*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 8 javëx7ditëx8orë= 448 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 19 441 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati i punimeve sipas grafikut = 43.39 ≈ 44 punëtorë*

***Punime dyer dhe dritare*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 8 javëx7ditëx8orë= 448 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 551 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati i punimeve sipas grafikut = 1.2 ≈ 2 punëtorë*

***Punime bojatisje*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 8 javëx7ditëx8orë= 448 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 2261 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati i punimeve sipas grafikut = 5.05 ≈ 5 punëtorë*

***Punime për ndërtimin e palestrës*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 23 javëx7ditëx8orë= 1288 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 19 462 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati i punimeve sipas grafikut = 15 punëtorë*

***Punime sistemimesh*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 16 javëx7ditëx8orë= 896 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 11 575 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati i punimeve sipas grafikut = 13 punëtorë*

***Punime instalimesh elektrike*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 23 javëx7ditëx8orë= 1 288 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 3 611 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati i punimeve sipas grafikut = 3 punëtorë*

***Punime instalimesh mekanike dhe hidraulike*** – Afati i punimeve sipas grafikut = 23 javëx7ditëx8orë= 1 288 orë

*Orë pune sipas zbërthimit të preventivit = 5 774 orë*

*Nr. i punëtorëve = Orë pune sipas zbërthimit të preventivit / Afati i punimeve sipas grafikut = 5 punëtorë*

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

**2.4.6** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovrator si dhe 4 shoferë kamioni, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Deshmi e Aftesise Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin kur punonjësit manovrator dhe shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

**Shënim:** Për përmbushjen e kësaj pike operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pare duhet te dorezojë pranë AK *përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit*, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Manovratorët që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

**2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte**

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015(e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi,

*i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**2.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

**2.7** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale të mëposhtme:

Licencë nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve”.

Licence për mbrojtjen nga zjarri të lëshuar nga QKL



**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

**2.8.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 18 (tetëmbëdhjetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik me kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator zinxhir	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë 3.5 – 5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinç eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinç kullë deri në 5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinç kullë 6 – 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator sipërfaqësor	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator thellësie	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobeton pompë	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere 500 l	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektroorgano	2 copë	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Trapan	4 copë	Pronësi ose me qera
Rul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri për skarifikim shtresash	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje bashkim tubash PE me elektrofuzion	1 copë	Pronësi ose me qera

Elektrosaldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera
Gazogjen	2 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike	1000 m2	Pronësi ose me qera
Zmerilatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Karroca dore	10 copë	Pronësi ose me qera

- Kokore minimumi 80 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 6 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 4 copë
- Prozhektorë ndriçimi minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 3 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 copë

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.*

*Operatori fitues **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit e vlefshme dhe fotot perkatese;
- (b) Ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plote të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plote të punimeve.
- (d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- (e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj si më poshtë:

***Punime dhe mbushje***

Sasia totale për transport 1520 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 35 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 43 ton

***Punime prishje***

Sasia totale për transport 3170 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 35 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 47 ton

***Punime dhe mbushje dhe punimet e prishjes janë procese pune që do të realizohen njëkohësisht prandaj sasia mesatare e transportuar në ditë do të jetë 90 ton. Për transportin e 90 ton materiale në ditë është përzgjedhur kamion mbi 18 ton i cili do të kryjë 5 rrugë në ditë.***

***Për realizimin e këtyre punimeve, nga zbërthimi i preventivit sipas analizave të çmimeve rezulton se nevojiten 1 matrapik me kompresor dhe 1 eskavator me zinxhir.***

<b>PUNIME DHEU DHE PRISHJE</b>	Op prev		Op grafiku	Nr. I mak
Ekskavator me zinxhir me kove 0.25 m3	0.07		280	0.0003
a)Matrapik me kompresor	49	60.25	280	0.22
a)Matrapik me kompresor	11.25			

***Punime murature***

Sasia totale për transport 178.6 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 35 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 5 ton

Kamionçinë 3.5 ton

*Për realizimin e këtyre punimeve, nga zbërthimi i preventivit sipas analizave të çmimeve rezulton se nevojitet edhe 1 vinç*

<b>PUNIME MURATURE</b>	Op prev	Total Op prev.	Op grafiku	Nr. I mak
Vinç	8.1	58.428	280	0.21 ≈ 1
Vinç	23.328			
Vinç	27			

*Punime betoni dhe hekur betoni (të cilat zhvillohen njëkohësisht)*

Sasia totale e betonit 135 m<sup>3</sup>

Sasia totale e hekurit 3 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 35 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 5 ton

Kamionçinë 3.5 - 5 ton

<b>PUNIME BETONI DHE HEKUR BETONI</b>	Op prev	Total Op prev.	Op grafiku	Nr. I mak
Vinç	102.375	108.795	280	0.39 ≈ 1
Vinç	6.42			
Vibrator	126.75	159	280	0.57 ≈ 1
Vibrator	8			
Vibrator	13			
Vibrator sipërfaqësor	11.25	56.1	280	0.20 ≈ 1
b) Auto beton pompe	6.6			
b) Auto beton pompe	49.5			

*Për realizimin e këtyre punimeve, nga zbërthimi i preventivit sipas analizave të çmimeve rezulton se nevojitet 1 betoniere, 1 pompë betoni dhe 1 vinç.*

*Punime çatie*

Sasia totale për transport 542 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 35 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 15 ton

Kamion 10 ton ( 2 rrugë në ditë) ose kamionçinë 3.5 -5 ton (3 rrugë në ditë)

***Për realizimin e këtyre punimeve, nga zbërthimi i preventivit sipas analizave të çmimeve rezulton se nevojitet edhe 1 vinç kulle deri 5 ton***

<b>PUNIME ÇATIE</b>	Op prev	Total Op prev.	Op grafiku	Nr. I mak
Vinç kulle deri 5 ton	13.9		280	0.05 ≈ 1

### ***Punime shtresash***

Sasia totale për transport 1942 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 63 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 30.8 ton

Kamion 10 ton ( 3 rrugë në ditë) ose kamion 18 ton (2 rrugë në ditë)

***Për realizimin e këtyre punimeve, nga zbërthimi i preventivit sipas analizave të çmimeve rezulton se nevojitet edhe 1 vinç kulle deri 5 ton dhe 1 elektroorgano.***

<b>PUNIME SHTRASH</b>	Op prev	Total Op prev.	Op grafiku	Nr. I mak
Vinç kulle deri 5 ton	0.5	196.5	504	0.39 ≈ 1
Vinc kulle	47.1			
Vinc kulle	109.9			
Vinc kulle	3.5			
Vinc kulle	28			
Vinc kulle	3.75			
Vinc kulle	3.75	16.75	504	0.03 ≈ 1
Elektroorgano	12.5			
Elektroorgano	2.25			
Elektroorgano	2			

### ***Punime suvatimi dhe veshje***

Sasia totale për transport 3784.73 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 56 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 67 ton

Kamion 10 ton (6 rrugë në ditë) ose kamion 18 ton (3 rrugë në ditë)

*Për realizimin e këtyre punimeve, nga zbërthimi i preventivit sipas analizave të çmimeve rezulton se nevojitet edhe 2 vinç kulle deri 5 ton, 1 elektroorgano, 1 trapan dhe 1 pompë suvatimi.*

<b>PUNIME SUVATIMI</b>	Op prev	Total Op prev.	Op grafiku	Nr. I mak
Vinç kulle deri 5 ton	285.48	897.78	504	1.78 ≈ 2
Vinc kulle	612.3			
Elektroorgano	351	351	504	0.70 ≈ 1
Trapan	180.9		504	0.36 ≈ 1
Pompe suvatimi	423.9		504	0.84 ≈ 1

***Punime për ndërtimin e palestres***

Sasia totale për transport 6415.82 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 161 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 40 ton

Kamion 10 ton (4 rrugë në ditë) ose kamion 18 ton (2 rrugë në ditë)

*Për realizimin e këtyre punimeve, nga zbërthimi i preventivit sipas analizave të çmimeve rezulton se nevojitet edhe 1 vinç kulle, 1 elektrosaldatriçe, 1 vibrator, 1 elektroorgano, 1 pompë suvatimi 1 trapan, 1 vinç eskavator, 1 vibrator sipërfaqësor dhe 1 gazogjen.*

<b>PUNIME PER PALESTREN</b>	Op prev		Op grafiku	Nr. I mak
Vibrator siperfaqsor	17.5	225.1	784	0.29 ≈ 1
Vibrator	8.1			
Vibrator	63.6			
Vibrator	75.4			
Vibrator	60.5			
Vinç	60.48	435.92	784	0.56 ≈ 1
Vinç kulle deri 5 ton	48			
Vinç kulle	57.6			
Vinç kulle	31.8			
Vinç kulle	24			

Vinç	60.48			
Vinç kulle	57.67			
Vinc kulle 6 - 10 ton	4.599			
Vinc kulle 6 - 10 ton	9.261			
Vinç kulle	4.5			
Vinç kulle	8.4			
Vinç kulle	58.08			
Vinç ekskavator	11.05			
Elektroorgano	20.6	20.6	784	0.03 ≈ I
Zmerilatrice	196.8	196.8	784	0.25 ≈ I
Elektro argano	254.1	254.1	784	0.32
Trapano	130.68	130.68	784	0.17 ≈ I
Pompe suvatimi	65.34	65.34	784	0.08 ≈ I
Elektrosaldatrice	84.15	84.15	784	0.11 ≈ I
Gazogjen	5.95	5.95	784	0.01 ≈ I

Për transportin e materialeve elektrike dhe hidraulike nevojitet një kamionçinë 3.5 - 5 ton.

***Punime për sistemimin e oborrit***

Sasia totale për transport 12 781 ton

Afati sipas grafikut të punimeve 112 ditë

Sasia e transportuar në ditë (mesatare) 114 ton

Kamion mbi 18 ton (5 rrugë në ditë)

***Për realizimin e këtyre punimeve, nga zbërthimi i preventivit sipas analizave të çmimeve rezulton se nevojitet edhe 1 eskavator me zinxhir, 1 rul me vibrim, 1 autobot uji, 1 betoniere, 1 vibrator thellësie, 1 vinç kulle, 1 elektrosaldatrice, 1 gazogjen, 1 autovinc, 1 vinc eskavator, 1 makineri për skarifikim shtresash.***

<b>PUNIME PER SISTEMIMET E OBORRIT</b>	Op prev		Op grafiku	Nr. I mak
Eskavator zinxhir	2.65	4.315512	896	0.00481642

Ekskavatorzinxhir	1.665512			
Rul me vibrim	0.832756		896	0.000929415
Autobot uji	0.416378		896	0.000464708
Betonjere 500 liter	123.5	172.25	896	0.192243304
Betonjere 500 liter	3.9			
Betonjere 500 liter	33.8			
Betonjere 500 liter	11.05			
Vibrator thellesie	311.6	433.86	896	0.48421875
Vibrator thellesie	27.88			
Vibrator thellesie	9.1			
Vibrator thellesie	85.28			
Vinc kulle 6 - 10 ton	6.3		896	0.00703125
Elektrosaldatriçe	8.91		896	0.009944196
Gazogjen	0.63		896	0.000703125
Autovinç	0.27		896	0.000301339
Vinç ekskavator	1.17		896	0.001305804
Makineri skarifikim shtresa	104.5		896	0.116629464

Pas përmbledhjes së makinerive sipas analizave teknike dhe shqyrtimit të grafikut të punimeve, si dhe duke gjykuar edhe nga mbivendosje e punimeve të ndryshme dhe eksperiencë e AK në zbatimin e punimeve janë përcaktuar makineritë e mësipërme.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.



Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit(shtojca8) gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do të jete kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

***Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Specifikimet teknike jane hartuar per çdo ze punimi te kesaj vepre sipas preventivit te hartuara nga projektuesi.*

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve teknike u bë prej anetares së njësi së prokurimit Kimete Curri me detyrë ing. ndertimi.